



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i VIII i botimit, nr. 106, gusht 2012

Nr. Llog. BKT 410027968, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, 0035692328116, internet: www.shoqatadukagjini.org, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## Luigj Gurakuqi dhe koncepti i tij për shtetin

Prof. Dr. Romeo Gurakuqi  
Universiteti European i Tiranës

Në këtë 100 vjetor të theme-  
limit të shtetit shqiptar, kur for-  
cat përparimtare të këtij vendi po  
përpiqen për me e ba funksional  
shtetin bashkëkohor, me sundim të  
së drejtës, me demokraci funksion-  
uese, liberale dhe parlamentare,  
trashëgimia që na kanë lanë pas  
Etërit e Kombit, asht një p...  
ve të referencës që do të du...  
së pari të mbështetemi.

2

## KOHA DHE E DREJTA ZAKONORE

LUIGJ SHYTI

Për atë që vuan, e do më shumë.  
Ne kemi vuajtur për jetën  
prandaj e duam shumë kemi vuajtur  
për lirinë prandaj e duam shumë,  
kemi vuajtur për tokën prandaj e  
duam shumë, kemi vuajtur për të  
mbrojtur besimin prandaj e duam  
shumë, kemi vuajtur për doket e  
zakonet prandaj i duam shumë.

Por koha ecën, ajo shkon vetëm  
përpara. Fitimtar është ai që ecën  
më të, përndryshe koha e len prapa,  
ajo është e pamëshirshme...  
me kohën është zgjuar...  
të zotësi.

4

## Pianisti

Tregim nga LAZËR STANI  
(vijon nga numri i kaluar)

3.

Kthehem prapë dhe ia ngulë sytë  
gruas në mes të kollonës, me krye  
të kthyer djathtas. E zmadhoj dhe e  
afroj pranë vetes këtë fragment të  
pikturës, duke e veçuar nga të tjerët.  
I ngjan një njollë të verdhë në fillim,  
pastaj vjen e qartësohet, trajtat e  
trupit i marrin formë, zbulohet...  
nga pak, si një skulpturë që...  
në sheshin e qytetit,

3

## Në përkujtim të grevës kombëtare të urisë së të përndjekurve politik, Tiranë 1991

Pranvera e Demokracisë - Me dëshirën e mirë të përkujtoj këtë ngjarje jo të zakonite, mbasi po afrohet dita jubilarë e saj SHTATOR 1991, do mundohem të rreshtoj disa kujtime në respekt të kolegëve që vendosen të vetëflijohen, për të ba prezent respektimin e të drejtave njerëzore dhe për të diskutuar ideologjinë vrasëse të komunizmit. Ja kushtoj këtë shkrim kolegut të paharruem të ndjerit Pano Taçi, i cili ishte pjesëmarrës aktiv i kësaj greve, me të cilin pata shumë biseda e shkëmbime mendimesh që më vlejten ma vonë.



7

## NJE QASJE KRAHASUESE

NJE POPULL QE NGRE KULTE, KUR KA BARKUN THATE DHE KOKEN BOSH,  
NUK MERITON TE QUHET I EMANCIPUAR!

Tek teoria e letersise thuhet se mjafton nje tingull, nje arome, nje ngjyre  
apo nje imazh dhe e kaluara piketohet në të tashmen. E kaluara, per ne  
shqiptaret nuk ka lënë ndonje shije të mire, që sot të mburrem...  
apo të kendojme ndonje lavdi para syve të të tjeveve. E sidomos ish...  
komuniste i asaj kohe, Enver Hoxha, emri i te cilit ka... Nga Lazër Kodra

5

## "JU JENI MIQTË E MI"

Fshati Hoti i Ri ndodhet 5 km në periferi të qytetit të Shkodrës. Në këtë  
fshat banorët e tij kush më parë e kush më vonë janë të ardhur nga vende  
të ndryshme. Të parët janë hotjanët (të cilët për shkak të reprezaljeve të  
malazezve në fillim të shekulli XX u larguan nga trojet e tyre shekullore),  
dukagjinas dhe malësorë, të cilët bashkëjetojnë duke e dashur dhe respektuar njëri- tjetrin. Në gazetën tonë ka... Nga Danjela Pjetri

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi Botimin:  
GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh Kimay  
PRODUCTION Produzione Giacche





# Pianisti



Tregim nga LAZËR STANI  
(vijon nga numri i kaluar)

3.

Kthehem prapë dhe ia ngulë sytë gruas në mes të kollonës, me krye të kthyer djathtas. E zmadhoj dhe e afroj pranë vetes këtë fragment të pikturës, duke e veçuar nga të tjerët. I ngjan një njollë të verdhë në fillim, pastaj vjen e qartësohet, trajtat e trupit i marrin formë, zbulohet pak e nga pak, si një skulpturë që zbulohet në sheshin e qytetit, duke sugjestionuar të pranishmit. "Ti je Monika, Monika flokëverdhë", ulërita krejtësisht i pavetëdijshëm. Nuk po u besojta syve. Në mes së kolonës së të verbërve qëndronte Monika, krejtësisht lakuriq, me krye të kthyer djathtas, me këmbën e djathtë të nxjerrë përpara, me gjoksin ende të ngritur lart dhe me hijen e pubisit të përmbytur nga një dritë e verdhë rrezatuese. Si është e mundur, them me vete, duke u përpjekur të mos humbas asnjë hollësi nga ky fragment i dashur, por i harruar prej dhjetra vjetësh. Nuk e mbaj mend mirë se kur e pashë Monikën për herë të fundit, as mbrëmjen e fundit që kaluam bashkë. Mbaj mend vetëm se atëherë punët po më shkonin për faqe të zezë: kisha dështuar në tre konkurse për punë dhe as nuk dija se di do ta mbaja frymën gjallë. Në Akademinë e Arteve nuk me qasën, për kompozimet e mia Teatri i Operas nuk ktheu kurrë përgjigje, si pianist nuk më pranuan as në Televizionin Publik. Për më tepër u tallën. "Nuk mund të mbajmë peng një talent si ti në orkestrën tonë", më thanë, duke më treguar derën. Kërkova të punoj si mësues muzike, diku në ndonjë shkollë, po as që bëhej fjalë. Drejtore-sha, një grua trupmadhe, as që e ngriti kokën të më shikonte, ndërsa unë i flisja për kërkesën time. Shgarraviste me laps zemra me shigjetë mbi gazetën që mbante përpara në tryezë. Dukej qartë se mezi po priste të mbaroja lutjen time për punë. Kur mbarova, ajo më tha se do ta mbante shënim emrin tim. Por asgjë nuk shkroi, as formalisht dhe as e mbajti dosjen time. "Më mirë merre me vete, tha. Këtu jemi shumë rrëmujë se do të zhvendosemi në një godinë tjetër. Mund të të humbasin dokumentet dhe nuk dua të mendosh që ne nuk jemi institucion serioz".

Unë u ktheva në banesën time të vogël dhe prita të vinin nxënësit që u jepja mësim private në piano. Askush nuk erdhi atë pasdite. Edhe ata më kishin braktisur. Fundja ata kishin të drejtë: pse do të merrnin mësim nga një pianist i papunë dhe nga një kompozitor veprat e të cilit nuk i përfillte askush.

Në darkë vonë erdhi Monika. Sapo shkeli në banesën time të shkretë m'u duk se brenda u derdh gjithë drita e qiellit. Vrapova ta përqafoj, po ajo u çlirua prej përqaimit tim ngadalë, duke u përpjekur që të mos më lëndonte. "A të luaj në piano atë që po më kumbon në shpirt tani", i thashë. Ajo bëri shenjë me dorë jo. Largo grumbullin e teshave të mia të pahekurosura nga divani dhe u ul. Pata përshtypjen se rrobat e mia të lara i ngjallën neveri teksa i prekte, po mundet se kjo qe vetëm një parandjenjë e keqe.

"A ke diçka për të pirë?" tha.

U çudita se Monika nuk pinte kurrë.

"Kam, i thashë, konjak Vecchia Romana dhe verë".

"Konjak", tha.

Unë mbusha dy gota plot me konjak, njërin ia zgjata Monikës, ndërsa tjetrën e mbajta për vete, duke qëndruar në këmbë përballë saj.

"Merr një karrike dhe ulu këtu", tha, duke më treguar vendin përballë saj. E kuptova se diçka shkante keq. Me erdhi ndërmend plaka Dranë, që i thoshte shpesh gjyshit: "Kur të vijnë të keqijat o burrë i dheut, hapu derën. Duhet me ju dalë për zot edhe të këqijave, jo veç të mirave". Mora një karrike të vjetër dhe u ula. Këmbët e karrigës kërcëllitën trishtueshëm nën peshën e trupit tim.

Ndeshëm instinktivisht gotat e konjakut dhe kthyem nga një gllënjë në heshtje. Unë po mendoja për Monikën e dikurshme, për takimet tona të para, pastaj veçimin tonë nga grupi. Një paradite, pasi pimë kafe, në kafenenë tonë të preferuar "Monarc" e ftova të vinte në apartamentin tim. Më përcolli deri te stacioni i autobuzit urban, po kur unë u bëra gati të ngjitesha në autobus, ajo nuk pranoi të vinte. Më përshëndeti më dorë dhe qëndroi në stacion deri sa më humbi nga sytë. U ktheva në banesë tmerrësisht i hutuar dhe nisa të luaj një melodi të trishtuar në piano. Nuk e dija se ku kisha gabuar me Monikën. Nuk dyshoja se ajo më dashuronte, po dreqi e di ku e kisha shkelur. Tani e quaja veten të humbur. Po, përkundër kësaj humbjeje, një hare e pakuptuar më lëvrinte në trup dhe e ndjeva se gishtërinjtë po më fluturonin me ritmin e muzikës që po luaja. Nuk e kuptoja ç'po ndodhte me mua.

Të nesërmen Monika më mori në telefon. Iu përgjigja ftohtë. Ajo qeshte në telefon dhe më tha të dilja ta prisja te stacioni. Do të vinte në banesën time. Zemra filloi të më rrihte fort, trupit po më shkrihohej e humbiste peshën. Mblodha plaçkat që kisha lënë kuturu nëpër dhomën e ndjenjes, rregullova shtratin për herë të parë pas shumë javësh dhe dola ta prisja në stacion në orën që më kish caktuar Monika. Prita në trotuar, si një hu i ngulur dhe më dukej se gjindja më shikonin dhe buzëqeshin nën buzë me tallje. Në kthesën kundruall u shfaq Monika, e veshur me një palë pantallona të ngushtë dhe një bluzë pambuku me vija të bardha dhe blu si bluzë marinarësh. Koka leshverdhë ngjante më shumë me një luledielli që ndjek e shkujdesur diellin e saj në hapësirë. Më hypën kacabujt njerëzit që kthenin kryet ta shikonin ndërsa ajo vinte drejt meje.

Kur mbërritëm në banesë, Monika më tha se nuk kishte fjetur gjithë natën. Nuk i shqitej nga mendja fytyra ime. Tha se nuk kishte parë kurrë një fytyrë burri

aq të dëshpëruar, me aq dhembje të lexueshme. "Pata frikë për ty", tha dhe më përqafoi, më puthi në buzë, në qafë, në gjoks përmbi këmbishën time të djersitur. Pastaj më tërhoqi ngadalë drejt dhomës së gjumit. U zhvesh vetëm në të brendshme përpara meje dhe u fut në shtrat, ndërsa unë e vështroja i shtangur. Kur u shtriva u ngjesh pas trupit tim që dridhej. Vonë atë ditë mbaj mend se më bëri një pyetje të çuditshme: "Si të duket fjala seks".

"Tepër e shkurtër", iu përgjigja aty për aty.

Qeshi e lumtur. Pastaj tha se besimet fetare e kanë demonizuar seksin. Dhe duke ia ngulur sytë kopjes së një vizatimi të Egon Schieles që mua ma patën dhuruar në Vjenë, shtoi: "Seksi nuk është mëkat". Edhe unë ngrita sytë dhe pashë vizatimin që varej në murin përballë, i futur brenda një kornize të lirë. Shkronjat qe tregonin diçiturën e vizatimit mbulonin përgjysmë shpatëzën e errët e kornizës.

"Schiele ishte i krisur", thashë unë, si për t'u mbrojtur nga imazhi provokues i gruas në vizatim.

"Unë do të kisha pozuar për të", tha Monika, duke më sfiduar.

Nuk kisha njohur kurrë një femër si Monikën. As në shtrat. Këmbën e djathtë e mbante gjithmonë të ngritur, ndërsa të majtën shtrirë. Trembej mos i lëndohej një nishan i frikshëm që gjendej pak mbi rrëzën e kofshës së djathtë. Dhe më binte vazhdimisht në kurriz me bulat e gishtërinjve të dorës së majtë, sikur interpretonte në piano. Kurrizi im ende i ndjen ato prekje ritmike, madje edhe kur shndërroheshin në ngulje thonjsh gjatë ekstazës.

"Do të largohem nga ky qytet, tha Monika, duke më përmendur. Do të martohem". E kuptova se edhe ajo po më braktiste. M'u kujtua plaka Dranë që thoshte shpesh: "Në ditë të zezë je vetëm, si në vdekje". Kishte të drejtë ajo, jo im gjysh që e kundërshtonte.

Pas asaj mbrëmjeje Monikën nuk e takova më kurrë. Madje as miqtë e mi të tjerë. Askush nuk i binte më numrit tim të telefonit. Po bluaja veten nga brenda, po shkatërrohesha. Pianon nuk e zija më me dorë, imagjinata më ishte bllokuar. Atë javë pashë thinjat e para që m'u shfaqën në tëmtha.

4.

Në një nga ato ditë kur nuk kisha më asnjë shpresë, takova rastësisht në rrugë, shokun tim të fëmijërisë, Pepen. Ishte shëndosur e zbukuruar, ndonëse vishej thjeshtë si fermer. Kur unë i tregova se si isha katandisur, nuk e zgjati. "Ti e di se merrem me tregti bagëti, tha. Eja puno me mua. Tregtia nuk më shkon keq dhe do të fitojmë të dy".

"Po ti nuk ke nevojë për mua", i thashë.

"Djemtë i kam të vegjël, tha. Jam krah i vetëm".

Nuk e prisja këtë ofertë të re pune. Rrija dhe vështroja Pepen dhe nuk dija si t'i përgjigjesha. Po Pepe e mori vetë vendimin për mua. "Lere atë zanat qyqarësh, tha. Jemi burra, s'na shkon sazja".

Pas një jave fillova punë me Pepen. Bridhnim fshat më fshat, bënim pazare, blenim kafshë të ndryshme, viça, lopë, qe, qingja, keca, dhi, cjepe, dele, desh, derra, pula, gjela, ç'të gjenim me hesap dhe ua shisnim kasapëve në qytet. Pepe i bënte vetë pazaret se nuk kish besim të unë, ndonëse atyre u thoshte për mua:

"Ky është bos i madh". Fshatarët ishin dinakë e dorështrënguar, po ku haheshin ata më Pepen. Gjithmonë dilte i fituar. Dalëngadalë e mësava edhe unë zanatin. Fitimet tona po rriteshin, blemë bashkë edhe një tokë që të ndërtonim disa stalla dhe një magazinë që ta përdornim si vend grumbullimi. Nuk pushonim kurrë, as ditën e dielë. Kur mbaruam ndërtimin e magazinës, iu luta Pepes të merrja pianon e ta vendosja aty në një qoshe. "Ah, psherëtiu. Merre, merre. Po mos rri natën zgjuar se na prët puna të nesërmen. Ne tani jemi bashkë. Ç'është e imja është edhe e jotja".

Më në fund rregullova një banesë të thjeshtë në një qoshe të magazinës, vendosa aty pianon që trashëgoja nga gjyshi dhe mbrëmjeve fillova të kompozoj. Ndi-hesha sërish i gjallë, i freskët, fantazia më ishte kthyer, imagjinata më flutronte në teatrot më të famshme të Evropës. Por, ditën i kushtohesha aq shumë punës sa Pepe ndjehej jashtëzakonisht i kënaqur, madje më tërhiqte herë pas here vëmendjen, duke qeshur: "Mendo dhe për veten. Martohu e krijo familje. Burri nuk kënaqet me saze, po me grua në shtrat". Unë habitesha se si Pepe nuk e mësoi kurrë fjalën piano. Kur donte të më ngacmonte, pasi kishtë bërë ndonjë pazar të mirë gjatë ditës e ishte në qejf, më thoshte: "Mos e lër sazen të ndryshket".

Në vitin e pestë të punës me Pepen, unë ndërtova shtëpi të re në periferi të qytetit dhe bleva një makinë që e mbylla në garazh. Atë vit njoha edhe Linën që sot është gruaja ime. E njoha në një fshat të thellë malor, ku zakonisht shkonim vjeshtave për të blerë bagëti, arra, gështenja, mjaltë, fasule. (Se harrova t'ju them se ndërkohë e zgjeruam biznesin). Atëherë Linda më pati habitur me bukurinë e saj të egër dhe me natyrën e saj prej fëmije. Sa herë më shihte në fshat fytyra i rrezëllente, sytë i shkëlqenin, pastaj skuqej dhe ulte kokën. Një ditë e pyeta për emrin, duke u kujdesur që fshatarët te mendonin se unë po e pyesja nëse kishte ndonjë bagëti për të shitur".

"Lina", tha shkurt.

"Emër i bukur", thashë unë kuturu. Dhe shtova: "Në lituanisht do të thotë fije bari, në hollandisht i thonë dritës, në greqisht i thonë e dëlirë, ndërsa në arabisht delikate dhe e dhembshur". Po të më kish degjuar Pepe, do ish shkrië së qeshuri. "O zot, çfarë hajvani je", do të thoshte e do të shkulej gazet. Por unë vërtë e kisha dashur gjithmonë këtë emër dhe dikur pata lexuar për kuptimin e tij. Me Linën them se u dashurova nga emri, ndonëse dhe e bukur ishte, s'ke ç'thua. Pas disa muajsh, Lina pranoi të martohej me mua dhe unë ndjehesha me të vërtetë i lumtur. Se ç'bëhej andej nga qytetet e mëdha nuk e dija, por pata degjuar se elitat në qytetin tonë, nëse dikush kujtohej për mua, më quanin "ai dështaku", ose edhe me keq "Ai matrapazi i bagëtive". Ata kishin të drejtë. Në univertetit kisha qenë më i miri, por të mirët dështojnë.

Por pas martesës me Linën, unë luaja pothuajse çdo natë në piano, kompozoja, shkruaja. Ajo më nxiste vazhdimisht te shkoja në dhomën ku kishim vendosur pianon, jo se i pëlqente, por se mendonte se kjo më bënte të lumtur. Dhe ajo nuk donte asgjë më shumë në këtë botë se lumturinë time. (vijon në nr.107)



# NJE QASJE KRAHASUESE

**NJE POPULL QE NGRE KULTE, KUR KA BARKUN THATE DHE KOKEN BOSH, NUK MERITON TE QUHET I EMANCIPUAR!**

Tek teoria e letersise thuhet se mjafton nje tingull, nje arome, nje ngjyre apo nje imazh dhe e kaluara piketohet në të tashmen. E kaluara, per ne shqiptaret nuk ka lënë ndonje shije të mire, që sot të mburremi me të, apo të kendojme ndonje lavdi para syve të të tjeveve. E sidomos ish udheheqesi komuniste i asaj kohe, Enver Hoxha, emri i te cilit ka mbi njezet vite qe perdoret nga qindra parti politike ne Shqiperi si mjet per kredo politike, mbeshtetur mbi bazen e fyerjeve me te sofistikuara e me monstruoze qe i jane bere nga te gjithë. Ju kujtohet ju te dashur lexues kur ne Shqiperine tone kishte rruge, sheshe, buste, kombine, hidrocentrale të cilat mbanin emrin e Enver Hoxhes. Ju kujtohen ju te dashur lexues kenget qe i kendoheshin shokut Enver? Besoj se ju kujtohen te gjithëve. Dhe nje dite, pas shembjes se regjimit, i thamë vetvetes: Më në fund shpetuam! E gjitha kjo ishte vetem nje genjeshter relative, pasi sindromat e se kaluares filluan te gjallojnë pëseri ne mentalitetin foshnjarak të shqiptareve dritëpakë. E them këtë pasi kenget per shokun Enver tani kendohen me të njëjtat motive e perkushtim idiotesk per shokun tone Sali! Dhe "trimat" tanë qe na udheheqen behen "te pamposhtur" ne brigjet e Adriatikut, dikush shkemb graniti, dikush fanar ndriçues e dikush tjetër murëprishes i Serbisë. Kujt i punon vetedija keto këngë i percepton si treguesin me te mire te nje populli te paemancipuar e shume larg mundeve per nje gje te tille, aq me teper shume larg aspirates evropiane. Ju kujtohet, te dashur lexues, kenga "Enver Hoxha e mprehi shpaten"?! Besoj se ju kujtohet te gjithëve. Ajo kishte nje tekst te admirueshem per nga forma, kompozimi muzikor dhe interpretimi, ndersa nje permbytje qe i shkonte per shtat vetem nje populli që kishte dale nga shinat e zhvillimit e rropataej ne vendnumero i mbeshtjellur nga guaska izolacioniste. Ja disa vargje: Enver Hoxha e mprehi shpaten/ edhe njehere

per situaten/ kjo eshte shpata qe u rri tek koka/ gjithe armiqve qe ka bota. E shikoni miq se sa fuqi kishte udheheqesi ynë!!! Aqsa te mbronte te gjithë boten nga armiqte e ndryshem!!! Por, per ne shqiptaret ky nuk ishte fundi, pasi simotrat e ketyre kengeve po degjohen edhe sot ne disa televizione te cilat vetem te tilla nuk mund te quhen! Ja disa vargje per trashigimtarin e denje te shokut Enver, Saliun tone "bërbjek e komunist të pamposhtur" me nje ekonomi kombetare qe vjen "menjehere pas Gjermanise": "Moj Serbi murin ta prisha / se mue m'thon Sali Berisha/ moj Serbi murin ta kalli/ se mue m'thone Azem

francezve, italianeve e gjithkujt ne bote! Bravo të qoftë o mushka e pabindur, se ti u kendon gjithnje vetem atyre qe te shtypin e te varferojnë! Rrofsh mjerane! Më falni se gati e pata harruar edhe nje ndryshim tjetër : Kur jepet kjo këngë per Saliun tone "madheshtor" tek TV-"BLU SKY" menjehere pas saj vijon nga kaseta kënga e Raxh Kapurit, në të cilen ka tri personazhe aq domethenese per kohen tone te pa bereqet. Raxh Kapuri, deputeti injorant e rrenacak qe mban gishtat perpjete ne emer te demokracise dhe zhgenjen gjithnje e gjithnje, gomari, ky besnik i perhershëm i fashatarit te varfer te cilit tashmë i bie të

punoje edhe token me parmendë dhe fshatari qe zhgënjehet nga gishtperpjetët dhe i duhet të mbijetojë në saje të gomarit të tij. Si thoni Ju... a ju pelqen ky realitet shqiptar? Te pakten një gjë nuk e ben mire ky TV..., eshte gjynah që pas kënges se te madhit Sali, Doktor, Rrumpallë, apo si te doni quajeni, të jepet menjehere nje kenge per një gomar fshati!!! Hajt t'i alternojme njehere vargjet e udheheqesve tane "te madherisem" Enver Hoxha e Sali Berisha: Enver Hoxha e mprehi shpaten/ Moj Serbi murin ta prisha/ Edhe njehere per situaten/Se mue m'thone Sali Berisha/ Kjo eshte shpata qe u rri tek koka / Moj Serbi murin ta kalli/ Gjith armiqve qe ka bota/ Se mua m'thone Azem Hajdari/ ... bukur ëëh? Vetem nje gje ndryshon midis tyre, rima nga e perputhur behet e alternuar, kjo nuk do te thote ndonje ndryshim esencial, por vetem modernizim i shkalles se dhunes! O Zot të biem në dorë, që t'u falesh pak mend shqiptareve, me qellim që munda i tyre, qofte mendor, krijues apo fizik të mos shkojë përlesh, por të pakten për pshesh, dhe ne te gjithë jemi dakord t'ia fillosh nga interpretuesja e kenges se Saliut, e mirenjohura Fatmira Breçani!

LAZER KODRA



# A ka vizion Populli Shqiptar apo vizioni i tij është të vrasë?

Pas vrasjes së një djali 22 vjeçar dhe plagosjes së vëllait të tij ditën e enjte në orën 19:30, forcat e policisë u vunë në ndjekje të autorit të krimit tmerrshëm që i preu në mes ëndrrat e të riut që kishte një dëshirë të madhe për jetën në të gjithë dimensionet e saj. Brenda natës policia bëri ndalimin dhe arrestimin e shtetasit Lazer Zef Lisi, 21 vjeç, banues në fshatin Bardhaj, Komuna Rrethina të rrethit Shkodër.

Gjin Guri ishte 22 vjeç dhe banonte në periferi të Shkodrës i ngjuar për shkak të gjakmarrjes së bashku me të gjithë familjen dhe fisin e tij që prej 4 vjetësh. A mund ta lidhni vallë brenda 4 mureve një 22- vjeçar i cili ka dëshirë të fluturojë, të rrëzohet, të ngrihet prapë, të eci dhe të vrapojë. Gjini sapo kishte filluar studimet universitare për matematikë kur xhaxhai i tij, Pllumb Guri, vret komshiu e Gjinit, Nard Lisi, pas një konflikti që kishin me njëri-tjetrin, konflikt që shkaktoi vdekjen e të ndjerit, burgosjen e Pllumbit dhe ngujimin e gjithë fisit Guri, për të vazhduar më pas me viktimën e radhës; Gjini e ri. E dinte rrezikun që i kanosej, prandaj priti sa të binte nata që të dilte dhe të shijonte pak liri me vëllain e tij në errësirë pasi "dritën ja



kishte burgosur axha Pllumb". Gjini kishte shpresën se një ditë do të lirohej dhe do të vazhdonte studimet sepse e donte matematiken, por gjakësi e ruante te dera. Nuk iu dridh dora të shkrehte automatikun mbi vëllezërit Guri edhe pse ata ishin të pafajshëm. Çfarë do ta ngushëlloj zemrën e prindërve që humbën djalin që mezi e rritën dhe që për pak humbën edhe djalin tjetër, Xhevahirin, i cili u plagos në të njëjtin moment kur vëllai u shënjestrua nga dora vrasëtare e atij që ndoshta kanë ndarë bukën bashkë.

Po ku është besa e Shqiptarit vallë! A mos ndoshta e vrau Kanuni? Apo njerëz me mendje të mbyllur kanë harruar se kur ngjyen bukën në një sahan me një person, e ke bërë vëlla për jetë. Dhe vëllai nuk mohohet e jo më të vritet për faj të dikujt tjetër. Avokati i popullit ka ngritur një taskforcë që të monitoroj punën e policisë dhe instancave të tjera që merren me rastet e gjakmarrjes. Drejtësia po zvarritet pak dhe po flet shumë se po bën luftën e saj kundër gjakmarrjes. 4 vjet kohë kishte drejtësia shqiptare ta ndalonte këtë vrasje, por dështoi. Edhe sa kohë do ta shtyjme kështu. Shqiptarët janë punëtorë, asnjëherë nuk kanë lejuar t'ia bëj punët e shtëpisë komshiu. Ku shkoi ky zell? Po na mbulon pislleku i krimit dhe i degjenerimit. Kemi harruar të shtrëngojmë dorën vëllait dhe ta shohim në sy me nderim. Një burrë i urtë ka thënë: "Një popull pa vizion vdes!"

A ka vizion populli shqiptar apo vizioni i tij është të vrasë?!

Nga VASILIKA ZEKA



# Në përkujtim të grevës kombëtare të urisë së të përndjekurve politik, Tiranë 1991

## Pranvera e Demokracisë



Pjeter Logoreci

Me dëshirën e mirë të përkujtoj këtë ngjarje jo të zakonite, mbasi po afrohet dita jubilarë e saj **SHTATOR 1991**, do mundohem të rreshtoj disa kujtime në respekt të kolegëve që vendosen të vetëflijohen, për të ba prezent respektimin e të drejtave njerëzore dhe për të diskutuar ideologjinë vrasëse të komunizmit. Ja kushtoj këtë shkrim kolegut të paharruem të ndjerit Pano Taçi, i cili ishte pjesëmarrës aktiv i kësaj greve, me të cilin pata shumë biseda e shkëmbime mendimesh që më vlejten ma vonë.

Në Shkodër, verën e vjetit 1991, në ndërtesën e familjes liridashëse e antikomuniste Martini, në katin përdhese gjindeshin zyrat e porsa hapuna të shoqatës së përndjekurve politik – dega Shkodër. Menjherë të binte në sy vorfonia e ambientit, që përveç do stolave a karrigave të vjetra, në zyrën e „kryetarit“ gjindej një tryezë e vjetër mbi të cilën qe vendosë një makinë shkrimit dhe vula e re e shoqatës të sapokrijume antikomuniste. Njerëz me fytra të vrame e të veshun keq hynin e delnin me ndonji pako ndër duer plot me rroba të vjetra ndihmash, apo me ndonji dëshmi panaliteti a dokumenta që vërtetonin vitet e vështira të burgut.

Vezullime shprese e radhë buzëqeshje mund të shihje ndër fëtyrat e rreshkuna prej diellit e vuetjjeve të burrave që përshkoheshin në derën e vjetër prej drunit sipër të cilës varej një tabelë e shkrueme me ngut nga një dorë amatore: Shoqata e të përndjekurve politik, Dega Shkodër.

Mbrendë, zotnajtë Vitor Martini e Ndreka Pjetri mundoheshin ti shërbenin çdo njërit me mirsjellje e gadishmëri, mbasi merrnin vesht shkaku e ardhjes së tyre. Nuk më kujtohet saktësisht dita, por ishte mbledhja e kryesisë së degës. Dhoma ishte plot me anetarët e kryesisë, të ftuem, njerëz të thjeshtë, simpatizantë e aktivista. Do të diskutohesh për hallet e shumta, por pika kryesore e rendit të ditës ishte thirrja e dergume të gjitha degëve të rrethve nga komiteti drejtues i shoqatës kombëtare në Tiranë e firmosur nga Mandela shqiptar Osman Kazazi, për pjesëmarrjen në një grevë kombëtare në Tiranë.

Edhe pse themelet e komunizmit tashma ishin lëkundun e plasaritun, klasa politike e kohës nuk ishte gati të njihje problemet e të shëronte plagët e viktimave të pafajshme të sistemit të tyre gjaksor. Pra duhej me çdo kusht që kjo shtresë përsëri të vetësakrifikohej në emër të lirisë e të demokracisë, për të arritë me realizue kërkesat e tyre minimale jetësore.

Bashkarisht u vendos pjesëmarrja në grevë. Edhe pse pat dëshira të shumta për pjesëmarrje nga gra e burra, u vendos të shkohej me një grup vullnetar prej 17 vetësh që ishin në gjëndje të përballonin vështirësitë. Greva do të zhvillohej në am-

bientet e sportklub Tiranës në Rugën e Kavajës në qendër të kryeqytetit.

Në paraditen e 20 Shtatorit te vjetit 1991 i gjithë grupi udhëtoj drejt Tiranës dhe ju bashkue pjesës tjetër të njerzve të ardhun nga të gjithë rrethet e vendit. Emocionet ishin të papërshkrueshme në takimet në mes të bashkëvujtesve. Kujtime të vështira e të paharrueshme për ditët e lanuna pas, por që lanë plagë të pashërueshme në fizikun e psikikën e tyre. Shtërngime duersh, perqafime, kujtime nga ma të ndryshmet, atmosferë e

tjetër babën e vdekur në burg e që nuk i dihej varri, një tjetër familjen..... Ishin rreth 2000 vjet burg në atë sallë sporti, që gjatë ditës, me ecejaket e grevistave të kujtonte oborrin e burgut famëkeq të Spaçit.

Këto njerëz ishin me mosha të ndryshme, me prejardhje të ndryshme familjare, por të burgosun nga i njëjti ligj famëkeq, ai i agjitacionit e propagandës.

5 kërkesat tona ishin nga ma të thjeshtat dhe krejt njerzore, për një jetë normale e integracion:

### 1. Pafajësia,



**Grupi i Shkodrës: (rreshi i parë në kambë)** Agostin Coku, Agron Dakaj, Vitor Martini, Bardhyl Lohja, Gjeta Vukcaj, Dedë Matusha, Pjeter Logoreci, (rreshi i dytë) Ilir Malaj, Skënder Ymeri, Tomë Beqari, Nikolin Keça, Paulin Ndoja, Martin Matusha, (ulë në tokë) Andre Barbullushi, Ilir Isufi, Gjergj Qamuku, Shtjefen Lacuku.

dhimbëshme por edhe kënaqësi miqësore. Mandej ndarja nga familjarët dhe mbyllja në sallë.

Të paharrueshme do të më mbesin çastet e betimit solemn për ta çue grevën deri në fund me çdo lloj çmimi, edhe me jetë. U zgjodh me shpejtësi një komitet drejtues i grevës, që do merrej me përkujdesjen shëndetsore të pjesëmarrësve që do kishin nevojë e për kontaktet me shtypin.

Situata politike në vend ishte shumë e veshtirë dhe delikate. Qeveria e stabilitetit e drejtuar nga Ylli Bufi nuk arrinte të kontrollonte situatën ku mbizotënonin lëvizjet për demokratizimin e vendit. Greva e mitingjet e njimbasnjishme që shprehnin pakënaqsinë popullore shtoheshin çdo ditë. Presidenti komunist Ramiz Alia dhe kasta e vjetër që e rrethonte ishin të padishrueshëm për njerzit. Të gjitha këto sollën një zemërim popullor që lexohej në sytë e çdo njeriu e që u shpreh me mirënjohje e perkrahje edhe për ne grevistët e urisë të ngjuem për të drejtat legjitime të mohueme.

90 persona të ardhun nga të gjitha anët e vendit, që ishin shtresa më e vuetjun e shqiptarve, ishin gadi të vetëflijoheshin për të kërkuar realizimin e të drejtave të tyre themelore të mohueme nga diktatura. Ish të burgosun e të internum, dikush që përfaqësonte vëllain e pushkatuem, një

jtat e njeriut e ish shokëve bashkëvujtes të burgut. Në mesin e ish të burgosurve, kishte edhe persona që rridhnin nga ish blloku, fëmijë të anëtarve të byrosë apo të anëtarve të komitetit qendror të partisë së punës, ministrave komuniste, të cilët ranë vetë viktime në burgjet që baballarët e tyre sajuen për njerzit e thjeshtë. Rasti e solli që të ndigjoj fjalë të mira për sjelljet e tyre në burg, por edhe nganjëherë pashë të kishte alergji e reagim negativ.

Aty nga dita e 8-të erdhën të na vizitonin një grup deputetësh dhe ministrash të qeverisë të stabilitetit, për të dhanë mesazhin që “po përiqeshin” të analizojnë kërkesat tona, e ndodhi që një ministër, djallë nga familjet komuniste të ish bllokut, u flak dhunshëm nga grevistët jashtë mbi asfalt....

Vetëmohimi për ta çue grevën deri në arrijten e plotësisht të kërkesave u ba motivi kryesor i qëndrësës të ishburgosurve edhe pse ishin të lodhur nga vuajtjet e burgut e nga mungesa e ushqimit gjatë grevës. Pat raste që grevistë dërgoheshin në spital për trajtim, por që me këmbëngulje kërkonin të ktheheshin pranë shokëve.

Çdo mbasadreke qindra qytetarë të Tiranës mblidheshin në oborrin para sallës sportive në shenjë solidaritetit. Shpesh ndodhte që të hidheshin parulla kundër qeverisë, kur nga dritaret e palestrës Viktor Martini apo Vladimir Xhelo njoftonin për gjendjen ditore të grevistëve.

Ditët kalojshin plot me rreziqe të dukshme në shëndetin e pjesëmarrësve, por prej shtetit vetëm heshje ... Dinosauri komunist Ramiz Alia, në rrokullisje e sipër, synonte përsëri jetë njerzore e gjak të pafajshëm. Ndonji deputet i opozitës, jo me prejardhje komuniste e që i njihje rrethanat e jetës së burgut si Pjeter Arb-nori, përiqej të imponohej te shteti, por pa rezultat.

Osman Kazazi, shtëpia e të cilit ishte ba bazë qëndrimi e informacionit për të ish të burgosunit e familjaret e tyre, ishte i angazhuem me kontaktet e bisedimet për realizimin e kërkesave me politikën. Ishte dita e 11-të. Gjendja shëndetsore dhe higjenike në sallën e grevës ishte e përkeqsue jashtë çdo kufini njerzor, kur një lajm i mirë ngrohu shpirtat e trazuem të gravistave. Qeveria e stabilitetit kishte vendosun të marrë parasysh kërkesat e të përndjekurve. Por rezultati konkret i lëvizjes sonë ishte rrëzimi më pas i qeverisë neokomuniste së stabilitetit dhe dalja e dekretit për zgjedhje të reja në shkurt 1992 ku demokracia fitoj bindshëm.

Pas 10 ditë greve, parlamenti miratoi njëzëri një ligj gjysmak, për të cilin të përndjekurit kanë edhe sot shumë pakënaqësi dhe ndjehen të pafajësuar.

Shpresoj që greva KOMBETARE E ISH TE PERNDJEKURVE POLITIK, në vazhden e lëvizjeve antikomuniste, do të zanë vend në mes të ngjarjeve të randësishme që janë të ekspozueme në muzeun kombëtar në seksionin e luftës kundër komunizmit.

## Xhelozia dhe zilia



Nga Roza Pjetri

Të dashur lexues, jeta na ka dhënë krahas të mirave edhe të këqijave, ku të parat të gjithë i duam dhe të dytat të gjithë nuk i duam. Për të mirat të gjithë krenohemi dhe e bëjmë vetën pjesë

të tyre, ndërsa të këqijave nuk i pranojnë dhe madje faksojmë të tjerët si shkaktarë. Në këtë shkrim me pak fjalë dua të sjell për ju disa mendime në lidhje me dy vesë të cilat i takojmë në jetë të pandara. Këto janë xhelozia dhe zilia.

Xhelozia mund të jetë një dëshirë kaq e zjarrtë në zemrën e një njeriu sa që mund ta vyshkë atë. Kur jemi xhelozë, zakonisht torturojmë njeriun që duam. Po, xhelozia mund të lindë urrejtjen, tradhtinë dhe nganjëherë vrasjen. Nga kjo rrënjë e xhelozisë kanë dalë mjerimi dhe dhimbja e pafund. Ajo mund të shkatërojë jetën familjare dhe madje edhe jetën e shoqërisë sonë. Nëse nuk jemi shpenguar prej vesit të dëshiruarit që të tjerët të na duan vetëm neve, kemi për të pësuar falimentim shpirtëror dhe jetët tona nuk kanë për të dhënë asnjë fryt, sepse, nëse në ne na sundon xhelozia,

atëherë jemi të paafte për të punuar me gjithë zemër në shërbim të së mirës. Xhelozia është një parahije e të vërtetës se si një dëshirë e tillë e keqe mund të na gërryjë trupin e shpirtin duke arritur të na largoj nga vetja jonë, nga të afërmit, të dashurit tanë e kështu do të gjen demit vetëm dhe shumë larg jetës. Por dashuria dëshiron të na çlirojë prej xhelozisë edhe sikur ajo të djegë si zjarr në zemrën tonë. Duke e ushqyer dashurinë ne arrimë tek shpengimi, i cili përfshin në vetvete një betejë të mirëfilltë besimi nga ana jonë kundër këtij vesi rrënues. Rëndësi ka që ta braktisim në mënyrë të ndërgjegjshme xhelozinë. Përndryshe do të jemi si pacienti që ka ilaçin më të mirë, por përsëri nuk gjen shërim, sepse nuk dëshiron të shkëputet prej rrethanave që janë përgjegjëse për sëmundjen e tij dhe që e përkeqësojnë vazhdimisht atë. Kërkohet që ta lëmë krejtësisht të lirë njeriun, dashurinë dhe vëmendjen e të cilit e kërkojmë me xhelozia.

Zilia është një rrënjë e helmët në shpirtin tonë, e cila mund të vrasë të tjerët. Njerëzit ziliqarë nuk mund të durojnë dot që fqinjët e tyre-sidomos ata që janë të barabartë me ta ose ata me të cilët banojnë-të kenë diçka më shumë apo më të mirë se ata vetë. Kjo është veçanërisht e vërtetë në ato sfera të jetës, të cilat na interesojnë më shumë, si: aftësitë intelektuale, bukuria dhe forca fizike, ose popullariteti dhe reputacioni, avantazhet materiale dhe bekimet e ndryshme në shtëpi apo në punë. P.sh mamasë ziliqare i dhemb shumë kur sheh se fëmija e

fqinjës së saj gëzon më shumë popullaritet nga fëmija e vet, ose nëse ai ka një martesë të lumtur në një kohë kur fëmija e saj nuk e ka këtë. Sa e sa herë ndodh që shohim vëngër thjesht nga që tjetri po ia çon shumë mirë. Në disa raste Zoti ju ka dhënë të tjerëve diçka që ne nuk e kemi. E për këtë arsye ne ndjehemi të dëshpëruar. Ndoshta ne nuk e shprehim direkt këtë pakënaqësi, por me disa mënyra jo direkt. Këtë dëshpërim e shprehim përmes grindjeve me të tjerët. Zilia është sëmundje kohëve të lashta, e kohëve moderne e çdo kohe. Zilia për arsye të ndryshme. Për arsye se tjetri ka popullaritet më të madh se ne. Për arsye se dikush është më i pasur se ne. Për arsye se dikush është më i ditur se ne. Kjo zilia, lind tek ne mungesën e gëzimit. Mوندohemi që ta justifikojmë me idenë e keqardhjes për veten tonë. Ne duhet të bëjmë përpjekje për të hequr qafe këtë ves jo të madhe në dukje, por që vjen e rritet tek ne. Ai është ves si të gjitha veset e tjera. Pasoja më tmerrshme e veseve është largimi prej vetvetes dhe të tjerëve. Të jetosh larg do të thotë që të ndjehesh i larguar prej çdo gjëje që e bën njeriun të lumtur. E të lumtur njeriun e bën e vërteta. Vetëm duke u bazuar në të vërtetën njeriu arrin qetësinë e shpirtit, zgjidhjen e problemeve. Kjo e vërtetë është që ne ndjehemi, ziliqar ngaqë dikush ka diçka që ne nuk e kemi. Ne duhet që këto vese të quajmë më një emër të vetëm mëkat i rëndë. Zoti ka dëshirë që t'ia tregoj secilit rrënjën e veseve. E kjo rrënjë gjendet në egoizmin tonë, në lakmitë tona shpirtërore apo materiale. Prandaj ne sot

duhet ti bëj këtë pyetje vetvetes. A jam i gatshëm që këtë egoizëm ta zhduk. Rrënja e dytë e zilisë është mosbesimi në drejtësinë e Zotit, mosbesimi se Zoti i ndan gjërat në mënyrë të barabartë. Të dashur lexues ka ardhur koha që secili t'i heq prej mendjes këto mendime rebele. Ne duhet të mendojmë që Zoti është vetëm dashuri. Atëherë si mundet që dashuria të bëjë vepra të padrejta. Përkundrazi dashuria na jep atë çfarë është më e mira për ne.

Çfarë do që të na dhurohet sigurisht që është më mira për ne. Rrënja e tretë e zilisë është mosmirënjohja. Ne na vjen keq për virtytet që nuk i kemi dhe tjetri i ka. Ne kurrë nuk e shohim virtytet tona, nuk marrim që këto virtyte të rrisim çdo ditë e më shumë në dobinë tone, të familjes dhe shoqërisë. Kurre nuk e shikojmë Venerën në brendësinë tonë për të shikuar virtytet që Zoti na i ka dhuruar. Por atje në thellësi i lëmë të fjetura dhe shikojmë virtytet e të tjerëve dhe bëhemi ziliqarë. Sa bukur do të ishte që të merreshim të gjithë së pari me vetveten. Çdo njeri të paktën e ka një virtyt dhe sikur çdo njeri të vihej në shërbim të rritjes së tij, botën do ta mbulonte e mira dhe e bukura. Por fatkeqësisht ne jemi të prirë të shikojmë të tjerët dhe të merremi me të tjerët.

Ah, sikur ne të merreshim me virtytet tona, nuk do të na sundonte xhelozia, zilia apo edhe veset e tjera.

Ah, sikur ne të merreshim me virtytet tona, sa të gëzuar dhe të rritur do të ishim, sa bukur do të na përkëdhelte jeta.

## "JU JENI MIQTË E MI"

Fshati Hoti i Ri ndodhet 5 km në periferi të qytetit të Shkodrës. Në këtë fshat banorët e tij kush më parë e kush më vonë janë të ardhur nga vende të ndryshme. Të parët janë hotjanët (të cilët për shkak të reprezaljeve të malazezve në fillim të shekullit XX u larguan nga trojet e tyre shekullore), dukagjinat dhe malësorët, të cilët bashkëjetojnë duke e dashur dhe respektuar njëri-tjetrin. Në gazetën tonë ka pasur disa herë shkrime që kanë paraqitur punën e mirë që po bëhet në këtë fshat në drejtim të edukimit të brezit të ri. E një rol të mirë në këtë edukim shpirtëror dhe shoqërorë po e bëjnë Motrat Françeskane të Zojës së Papërlyer. Edhe këtë vit u zhvillua kampi për fëmijë në një hark kohor një javor nën logon "JU JENI MIQTË E MI".

Morën pjesë nxënësit e shkollës 9-vjeçare të këtij fshati nga niveli parashkollor deri tek nxënësit e klasave të 9-ta. Qëllimi kryesor i këtij kampi ishin edukimi i fëmijëve, të mësuarit për të bashkëpunuar në grup. Gjatë këtyre ditëve fëmijët mësuan të bashkëdijonin dhe mbështesin mendimin e njërit-tjetrit dhe çdo gjë ta bënin së bashku në orën e vizatimit, në orën e argëtimit, pra zbatimet nëpërmjet lojërave nga me të ndryshmet. Gjithsej ishin 6 grupe. Pjesëmarrja e fëmijëve ishte e lartë. Por, ajo që të bënte më shumë përshtypje ishte

pikërisht fakti se, në çdo disiplinë të lojërave, në kuadrin e zbatimit të programit të përditshëm u vu re një interesim mjaft i lartë dhe përkushtim i plotë i fëmijëve. Kështu në një ditë të thjeshtë në çdo moment i shikoje ata të punonin nën frymën e grupit dhe sigurisht shumë të gatshëm për të dëgjuar drejtuesit e secilit prej grupeve apo siç quheshin ndryshe anima-



torët. Të rinjtë animator janë përgatitur që më përpara nga Motër Diana Marku. Këta animatorë kanë bërë një punë të palodhur duke i kushtuar dhe një pjesë të mirë të kohës së tyre për mbarëvajtjen sa më të mirë të kampit. Dhe në fakt

rezultatet e punës së tyre ishin mjaft të dukshme në koncertin e përmbjlljes, ku vendi ishte mbushur plot e përplot me prindërit, gjyshërit e të rinjtë. Në oborr u hap ekspozita me punimet e fëmijëve ku nga duart e vogla me dashuri dhe durim ishim krijuar punime mjaft të bukura. Çdo grup duhej të shfaqte punën që kishte realizuar gjatë gjithë javës, që

ngelur mjaft të kënaqur saqë shikohej në fytyrën e tyre një kënaqësi që ishte e pamundur të fshihej. Ndërsa gjyshërve sikur iu ishte shtuar edhe një pjesë jete tekta shikonin nipat e mbesat e tyre sidomos me të vegjëlit të recitonin, të këndonin, të kërcenin aq bukur përpara syve të tyre. Prindërit fotografonin fëmijët e tyre duke ditur se të tilla veprimtari mbesin gjatë në mendjen e fëmijës së tyre, si një shenjë të fëmijërisë, të cilën sido që të jetë do ta kujtojnë si diçka mjaft të bukur, e cila i kishte shoqëruar në periudhën më të magjishme të jetës së një njeriu, pra në fëmijëri. E në përfundim të gjithë kësaj fjalën e mori Motër Lidia Kçira, e cila falënderoi të gjithë ata që kishin ndihmuar në mbarëvajtjen e kampit. Me pak fjalë ajo solli për të pranishmit rëndësinë e edukimit të brezit të ri ku në këtë edukim ka mjaft rëndësi bashkëpunimi i familjes, shkollës, kishës dhe shoqërisë. Të punojmë me brezin e ri, do të thotë se kemi hedhur hapa të sigurtë për ndërtimin e së ardhmes. Kisha, familja, shoqëria duhet të bashkëpunojë që fëmijët tanë të rriten në virtyte të cilat ne si shqiptarë i kemi trashëguar nga njëri brez në tjetrin. Fëmijët presin shumë nga bashkëpunimi ynë. Ajo nuk e fshehu dëshirën për vazhdimin edhe në vitet e ardhshme. Një javë kalon shumë shpejt, por duke lënë gjurmë të thella në mendjet dhe zemrat e banorëve të fshatit, tregon se veprimtari te tilla duhen zhvilluar herëpashershme ne shërbim te edukimit te fëmijëve dhe te rinjve.

Nga Danjela Pjetri



# "KELMENDI NË SHEKUJ"

(Veprimtari shkencore)

Me datën 10 gusht 2012 në njërin nga mjediset turistike në Qafën e Predelecit u zhvillua simpoziumi shkencor "Kelmendi në Shekuj", organizuar nga Komuna Kelmend dhe Universiteti i Prishtinës. Në këtë veprimtari merrnin pjesë shumë malësore nga Kelmendi dhe banorë që banojnë jashtë Kelmendi, nga SHBA, Mali i Zi e Kosova. Mori pjesë edhe një grup nga Shoqata "Atdhetare Dukagjini", i ftuar nga Kryetari i Komunës së Kelmendit, Ndue Sanaj, Luigj Shyti, Aleks Dushi e Dede Zhivani. Këtë veprimtari e nderuan me pjesëmarrjen dhe kumtimet e tyre shumë profesorë nga Universiteti i Prishtinës, Tetovës, Universiteti i Budapestit, Universiteti i Elbasanit, studiues nga fusha të ndryshme për problemet e gjuhësisë, historisë, folklorit, etnologjisë, kulturës, gjenezës, e të tjera.

Shpërndarë në katër seanca, pas përshëndetjeve të rastit si nga Kryetari i Komunës Gjeto Dukaj dhe të tjerë, u paraqitën këto tema:

1. Prof. Dr. Abdullah Zymeri, Prizren, Universiteti i Prishtinës, "Venerime gjuhësore e leksikore në folklorin e Kelmendit.
2. Prof. Dr. Begzad Baliu, Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, "Të dhëna gjuhësore për emërtimin Kelmend".
3. Prof. Dr. Etleva Lala, Eötvös Loránd Tudományegyetem, Budapest, Hungari, "Burime dhe dokumente origjinale nga *Archivio Segreto Vaticano* për Kelmendin dhe veriun e Shqipërisë në shek. XIV dhe në fillimshkullin XV".
4. Prof. Dr. Musa Ahmeti, Center for Albanian Studies, Budapest, Hungari, "Kelmendi-kelmendasit dhe klerikët që shërbyen atje sipas Schedario Garampitë në *Archivio Segreto Vaticano* nga shek. XIII deri në shek. XVI".

5. Sahit Kokolli, Prishtinë, Filmi dokumentar «Lahutari i fundit».

6. Dr. Ing. Mark Palnikaj, Tiranë, Universiteti Politeknik, Tiranë, "Gjendja e Kelmendit në shekullin XVII, bazuar në relacionin e Frang Bardhit".

7. Dr. Luigj Martini, Shkodër, "Vështrim historik i përpjekjeve të trevës të Kelmendit për liri dhe pavarësi deri në fund të shek. XVII".

8. Mr. Arben Arifi, Instituti i Historisë, Prishtinë, "Kelmendasit dhe Papa Klementi XI Albani (1649-1721)".

9. Prof. Dr. Ali Muriqi, Universiteti i Prishtinës, "Zhuji Selmani nga Rugova, figurë emblematike e Lëvizjes Kombëtare

15. Sokol Paja, Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan: "Qëndresa e Kelmendit në vigjilje të vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri".

16. Prof. Dr. Enver Mehmeti, Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, "Tekstet folklorike të kelmendasve të vendosur në krahinën e Sremit të Kroacisë".

17. Prof. Dr. Agron Xhagolli, Tiranë, Qendra e Studimeve Albanologjike, "Malësia e Madhe, vatër e praktikimit të këngëve të kreshnikëve".

18. Prof. Dr. Hamit Xhaferi, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, "Disa dukuri të Eposit të Kreshnikëve në Kelmend".

19. Prof. Dr. Zymer U. Neziri, Instituti

ali i lindjes në krahinën e Rugovës".

25. Liburn Aliu, Prishtinë, "Të dhëna etnohistorike për kelmendasit në Presevë me rrethinë".

26. Frrok Kristaj dhe Nikollë Kërhanaj, Zym, "Kelmendasit në Zym të Hasit, Komuna e Prizrenit: të dhëna etnohistorike".

27. Ilire Kelmendi-Shema, Prishtinë, "Kelmendasit-muhaxhirët e Sanxhakut të Nishit të ardhur në Prishtinë me rrethinë: të dhëna etnohistorike".

28. Isuf Koci, Prishtinë, Këshilli i Kosovës i Trashëgimisë Kulturore "Kelmendasit në krahinën e Drenicës: të dhëna etnohistorike".

29. Arsim Havolli, Prishtinë, Këshilli i Kosovës i Trashëgimisë Kulturore "Kelmendasit në krahinën e Llapushës: të dhëna etnohistorike".

30. Idriz I. Kelmendi, Lipjan "Kelmendasit e Lipjanit me rrethine, të dhëna etnokulturore".

Për nga shtrirja mund të thuhet se ishte një veprimtari ndërnacionale, pavarësisht se të gjithë referuesit ishin shqiptarë. Temat ishin shumë interesante dhe duket se është bërë një punë mjaft serioze hulumtuese dhe organizuese, e cila duhet përshëndetur. Është për të ardhur keq që në këtë veprimtari mungonte fjala e profesorit të Universitetit të Shkodrës. Mungonin gjithashtu edhe drejtuesit e qarkut, prefekturës të Shkodrës dhe nënprefekturës së Malësisë së Madhe, gjë që nuk kaloi pa u vene re dhe krijuar përshtypje jo të mirë.

Kjo veprimtari ishte një shembull i mirë për zbulimin dhe publikimin e historisë dhe kulturës së kësaj krahine me vlera shumë të mëdha, në të gjithë kohërat.

Veprimtari si kjo janë për tu marrë si shembull pozitiv me shumë vlera. Shënojmë se kjo veprimtari nuk ishte e organizuar nga ndonjë OJF, por nga organet e qeverisjes vendore në bashkëpunim me institucione shumë të rëndësishme shkencore brenda dhe jashtë vendit.

**Nga korrespondenti i gazetës "DUKAGJINI"**

## MINISTRIA E DIASPORËS E REPUBLIKËS SË KOSOVËS TUBON TËRË MËRGATEN SHQIPTARE

... unë ndihem krenar që sot këtu së bashku me ju kam kënaqësinë që para lexueseve shqiptare të sjell një kontribut modest të kulturës së shkruar shqiptare, përmes dy librave, të cilat bëjnë fjalë për tere hapësirën dhe për njerëz të shquar të kësaj hapësire shqiptare, por edhe për njerëz të tjerë merituar nga e tere bota ...

Medvegje, 4 gusht 2012. Këto dite vape verore, Ministria e Diasporës e Republikës së Kosovës, po zhvillon aktivitetet kushtuar mergates shqiptare, e cila gjendet në pushimet e verës në vendlindje. Përveç aktiviteteve të tjera në Prishtinë u organizua promovimi i veprave të katër krijueseve letrar që punojnë dhe veprojnë në mërgim: Fatmir Brajshori-"Toplice, një foshnje mbi Berlin", Dashnim Hebibi-"Intervista në tranzicion" libri i I dhe i II, Salih Zog-jani-"Anegdota 5" dhe Abdurahim Ashiku-"Me njerëz që i dua". Ishin këto vepra me tematike të ndryshme që

Shqiptare"

10. Ndue Bacaj, Shkodër, "Kelmendi gjatë kryengritjeve më 1911-1912".

11. Prof. Dr. Ahmet Osja, Shkodër, "Malësia e Madhe në vigjilje të ngritjes së flamurit dhe të shpalljes së pavarësisë së shtetit shqiptar në Vlorë, më 28. XI. 1912".

12. Prof. Dr. Lush Culaj, Instituti Albanologjik i Prishtinës, "Marrëdhëniet jugosllave-shqiptare dhe çështja e Vermoshit".

13. Binak Ulaj, Vuthaj, "Vështrim për pushtimin e Plavës e të Gucisë më 1912 dhe për vijimësinë e jetës në robëri deri më 2012".

14. Ali Daci, Rozhajë, "Rozhaja në 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë".

Albanologjik i Prishtinës, "Lahutarët e Kelmendit në SHBA, në fondet arkivore të Universitetit të Harvardit".

20. Prof. Dr. Mark Tirta, Tiranë, "Kelmendi në kujtesën e shekujve, në doke, rite e mite".

21. Dr.sc. Bashkim LAJÇI, Muzeu Etnologjik, Pejë, "Disa aspekte të tabusë në doke e zakone të kelmendasve".

22. Kelmend Karuni, Tiranë, "Filmi dokumentar «Misteret e xhuletës shqiptare»".

23. Shukrane Begu, Muzeu Historik-Etnografik i Vushtrrisë, "Prezantimi i veshjes së Rugovës në Muzeun Etnologjik të Pejës".

24. Jehona Hajrullahu, Prishtinë, "Ritu-

hur kështu personalitete të shquara nga të gjitha sferat e jetës, por që këtu përbejnë si të thuash, atë gjeografinë etnike shqiptare, nga se Hebibi ka intervistuar njëllor nga të gjitha trevat e gjeografisë sonë nacionale nga Shqipëria, nga Kosova, nga Maqedonia, nga Presheva, por edhe nga diaspora shqiptare në Evropë dhe në Amerikën e largët, pra veprimtari e personalitete të shquara e të dalluara ... Dashnim Hebibi ka zhvilluar një teknike intervistimi, që do ia kishin lakmi edhe shkollat me të njohura të gazetarisë duke kultivuar në këtë drejtim, posaçërisht të ashtuquajturën "Interviste prominente", por edhe atë "investigative" dhe se gazetari posaçërisht i specializuar në interviste është i vetmi që mund të ia dale në misionin e tij dhe Dashnim Hebibi edhe me këto libra ia del, duke dëshmuar profesionalizëm të lartë e duke i dhënë një kontribut të madhe gazetarisë dhe publicistikës shqiptare në diasporë dhe hapësirat shqiptare në përgjithësi ...".

Duke i përshëndetur dhe falënderuar

të gjithë të pranishmit, Dashnimit tha: "... unë ndihem krenar që sot këtu së bashku me ju kam kënaqësinë që para lexueseve shqiptare të sjell një kontribut modest të kulturës së shkruar shqiptare, përmes dy librave të cilat bëjnë fjalë për tere hapësirën dhe për njerëz të shquar të kësaj hapësire shqiptare, por edhe për njerëz të tjerë merituar nga e tere bota ...".

Në këto promovime ishin: Ministri i Diasporës së Republikës së Kosovës, zëvendës ministri, Ambasadori i Republikës së Kosovës në Austri e shumë personalitete të tjera nga jeta artistike e politike e Republikës së Kosovës si edhe njerëz nga të gjitha hapësirat etnike shqiptare. Nga Medvegja në këtë promovim morën pjesë Zenel Neziri, kryetar i SH. H. "Medvegja" në Zvicër dhe prof. Rexhep Abazi, kryetar i UDSH-së për Medvegje.

Urojme që Dashnim Hebibi dhe krijuesit e tjerë të kenë shëndet të mire dhe vullnet për të krijuar edhe vepra të reja letrare e artistike për kulturën shqiptare e atë botërore. Nga prof. Rexhep Abazi

# FESTË NË KOMUNËN E DAJÇIT TË BREGUT TË BUNËS

Ne kuadrin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, me datën 21 gusht 2012, ne komunën e Dajçit, ne mjedisin e Kishës së Shën Prendes-Shirq, u zhvillua një veprimtari festive, ne të cilën morën pjesë banorë të kësaj komune, emigrantë të zonës, klerikët Dom Gjergj Simoni, Dom Gjovalin Sukaj, Dom Vlash Palaj, Dom Ardian Arra, imam Suad Leka, imam Kujtim Cufaj, miq e të ftuar nga autoritete të pushtetit vendor të Qarkut Shkodër, ne veçanti deputeti i Qarkut Shkodër Gjok Uldedaj dhe Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër, Maxhit Cungu, kryetaret e komunave fqinje. Ishin të ftuar edhe nga Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" dhe morën pjesë Ndue Sanaj, mjeshtri Ahmet Osja e Aleks Dushi.

Ne fjalën e rastit e mbajti kryetari i komunës Arben Gjuraraj, ne mes të tjerave u ndal: "... Jemi mbledhur ne këtë 100 vjetor të Shpalljes së Pavarësisë pranë këtij vendi të shenjtë e të hershem, pranë këtij vendi ku princër e mbretër kurorëzovnin martesat e tyre, pranë këtij vendi ku bashkohen qytetërime e tradita të vjetra e të reja. Pranë këtij vendi e rrethinave të tij zunë vend hershem banorë e popullata, aktivitete të rëndësishme ekonomike, transporti lumor, tregtia, peshkimi e bujqësia.

Pozicioni gjeografik e lumi Buna e shndërruan këtë rajon në një prej vendeve më të rëndësishme që lidhte Shkodrën me detin Adriatik e për rrjedhojë me të gjitha vendet e pellgut të tij. Ky vend, por dhe kjo Kishë përmenden që herët në histori, ndërtohet në nderim të Zotit, por dhe në shërbim të kulturës dhe jetës së popullatës pranë saj.

Historiane e studiuës kanë folur e do të flasin çdo ditë e me shume për këtë vend jo vetëm të gojëdhënave të shumta e të hershme, por edhe të fakteve të pakundërshtueshme që e bëjnë padyshim një prej mbetjeve më të rëndësishme të historisë e kulturës së këtyre trevave dhe mbare shqiptareve.

Shirqi, ashtu si dhe fshatrat e tjerë përgjatë Bunës si Kroqi e Prekali, Pentari e Belaj, Rrushkulli e Samrishi, Dajçi e Oboti, Suka, Gramshi e Mushani, Darragjati e Katalina janë përmendur shume herët si vendbanime të hershme të shqiptareve, dhe me vonë edhe si rrugë lidhëse e rëndësishme të shkëmbimeve tregtare të Shkodrës me krejt rajonin.

Zyra e doganës dhe shumë magazina e sheshe ku depozitoheshin mallra të importuara ose për eksport, si magazinat e kripës, verës, drithit dhe sheshet e grumbullimit të lëndës së drurit, qeramikës e të tjera, e bëjnë padyshim Shirqin një qytet-port të rëndësishëm të rajonit. Mirëpo ky vend do të kalonte edhe periudha të vështira siç i gjithë populli shqiptar. Luftërat që vinin njëra pas tjetrës nuk i gjeten asnjëherë indiferent banorët e këtyre zonave. Edhe ata morën pjesë sa here atdheu i thërriti. Edhe fenomenet shkatërruese natyrore nuk e kanë kursyer këtë zonë. Por tashme zona ishte bere e njohur si zonë punëtoresh të palodhur. Ashtu si dhe Kisha edhe vendbanimet u rindërtuan disa here mbas shkatërrimeve.

Zona ishte kthyer në një zonë ku zhvillo-

hej mjaft mire bujqësia e blegtoaria, peshkimi e gjuetia. Kjo e kishte bere zonën të pëlqyeshme dhe për banorët të tjerë që vijnë nga vise të ndryshme të Shqipërisë së Veriut, nga Dukagjini e Malësia e Madhe, nga Kraja e Ana e Malit, nga Zadrima e Mirdita për tu bere pjesë e pandare e Bregut të Bunës. Do të ndërtonin një jete ne



jësit historike shpirtërore, para të cilëve përulemi me respekt të gjitha ato që dhënë jetën për këtë vend e për vlerat me të larta njerëzore. Eshte rasti me i mire për të përkujtuar artiste të paharruar të kësaj zone, dëshmorë të atdheut e profesorë të nderuar. Nuk mund të le pa përmendur aktin patriotik të 17 anëtareve të parisë së Dajçit, të udhëhequr nga Meshtari i tyre Nikoll Radovani të cilët iu bashkuan dhe zonave të tjera duke i shkruar Konferencës së Paqes për njohjen e kufijve.

Po ashtu nuk mund të harrohet pjesëmarrja e banoreve të Dajçit në lëvizjen për rrëzimin e diktaturës komuniste dhe me pas mbështetjen e vazhdueshme të proceseve demokratike.

Nderojmë sot dhe krejt trupën e arsimtareve dhe edukatoreve tanë të nderuar, një pjesë e të cilëve është sot mes nesh që me durim nguliten nder ne dije e vlera të larta të paqes e harmonisë.

Nderim dhe për ata që nuk gjinden mes nesh por që do të kujtohen në përjetësi!

Qofte i bekuar ky 100 vjetor i Shpalljes së Pavarësisë!"

\*\*\*

Veprimtarinë festive e përshëndeti: Kryetari i Qarkut Shkodër, Maxhit Cungu; Deputeti i Qarkut Shkodër Gjok Uldedaj; Imami i zonës, Kujtim Cufaj; Famullitari i Dajçit, dom Marjan Gega.

Këshilli i Komunës Dajç ka nderuar me Tituj Nderi disa prej personaliteteve me të spikatura, bij të lindur e të rritur dhe që kane shërbyer në Dajç:

a) Me titull "Krenaria e komunës së Dajçit":

1\* Kompozitorin e madh, "Artistin e Merituar", Pjeter Gaci, pas vdekjes, lin-

nës së Dajçit":

1\* Shoqatën e Emigrantëve të Dajçit në Itali "Alba- Migrantes",

2\* Dom Marian Gega.

Ne koncertin e dhënë direkt me këtë rast u interpretuan: Vargjet Nene e Bij të Vincens Prendushit nga Marcel Daka, Diana Parubi, Marinela Parubi; vallja "Flutura" e interpretuar nga grupi i vajzave; Berti-orkestrale të Pjeter Gacit; valle humorit "Gjel Kokoshi" të interpretuar nga Gjovalin Daka, fitues i çmimit në festivalin Gjirokastrës, me grupin e djemve; vargje të poezisë "Varfëria dhe Liria" të Andon Zako Çajupit që u interpretuan nga Rozeta Kopshti; poezia "Atdheu" e Gjergj Fishtës e interpretuar nga Artisti i Merituar Lazer Filipi; dhe u mbyll me himnin e Gjergj Fishtës.

Festa e komunës së Dajçit të Bregut të Bunës, ne kuadrin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, u mbyll me një koktej.

\*\*\*

Me këtë rast i bëjmë thirrje drejtuesve të komunave të zonës së Dukagjinit të bëjnë përpjekje të organizojnë, të përgatisin e të zhvillojnë veprimtari në kuadrin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë dhe të mos mbesin prapa komunave të tjera të Qarkut Shkodër, të cilat janë vu në lëvizje dhe po zhvillojnë veprimtari të ndryshme në këtë kuadër.

Nga korrespondenti "Dukagjini"

poezi \*\*\* poezi

## FSHATIT LOTAJ

Shqipja shkon tuj fluturue,  
Ne Lotaj t` Shalës ka pushue,  
Ne këtë vend nderto folene,  
Ku ka ruajt besen e fene,  
Brez pas brezi e djal ças djalit,  
I kan dale për Zot vatanit  
Ktu kan dal trima me fletë  
Ktu kan dal dragoi t` vertetë,  
Perkrah tyre shqiponja eci,  
Njaj Prek Gjoni e Kol Mark Geci,  
Me kmishë veshë i pat ba nana,  
Lart në bjeshke mrrizue me zana,  
Kol Mark Kola trim ka dalë,  
Me begollin i pat dy fjalë,  
Në Shalë ty kush t` ka çue  
E ka ba pleqnin pa mue,  
Pushka e ti ka ruejt bekimin,  
Ka nderë Lotajt e Dukagjinin,  
Patriot me vlerë kombetare,  
Zot i duel tokes shqiptare  
Se ne Lotaj e pat vatanin  
Ku e njeh shqipja Zef Tushanin,  
Nje rilindas i vertetë,  
N` histori gjithmon do të jetë,  
Del kushtrimi shpi per shpi,  
Turku Shalen e paska msy,  
Miter Kola del ma i pari,  
Me top dardhe ne qaf- Agri,  
Per atdhe e emer t` fisit,  
Flak barutit qet prej lisit,  
Mehmet shpendi thrrret djelmnin,  
Me ruejt token me ruejt lirin,  
N` Lotaj tha: ka djem si zana,  
Shokt e tyne si ban nana,  
Të gjith gati per nder t` vatanit,  
Po thrrret Deden e Lulash Peranit,  
Me e dhan jeten per liri,  
Tuj luftue me Mal te Zi,  
Historia per ta foli,  
Njaj Kol Pjetri e Lulash Sokoli,  
Ai Grime Ndou si burrat ra,  
Gisht per gisht ka mbet me shkja,  
Dalin t` paret kur ndjejn poteren,  
Bejto Ndoci me Nik Deden,  
Eshte e shtrenjte per ta liria,  
Bicel Kola e Kol Delia,  
Lulash Deda ne luftë po shkon,  
E merr pushka, por qendron,  
Ra deshmor i lirisë,  
Mirash Pali lule e rinisë,  
Orët e malit kengen nisin,  
Kur kujtojne Mikel Koliqin,  
Emni tij u shkruet me arë,  
Kardinali i par shqiptarë,  
Dhe Ernesti vellai i tij,  
Eshte baba ne letersi,  
Shkrou per malet e per lirinë,  
Kjen prej Lotajsh me origjinë,  
Kush ma mir pleqni nuk bani,  
Se Gjelosh Gjoka e Shytan Vuksani,  
Mirash Uka e Sokol Vuksani,  
Njoft i pat gjithë Dukagjini,  
Buzhet Marku ai pike trimi  
Nder kuvende fjala u çeli,  
Kti Pllum Noks e Vogel Biceli,  
Sofra shtruet midis trollit,  
Kti Mhill Ndreut e Marash Sokolit,  
Zef Gjeloshi i Gjelosh Markut,  
Me lahute ne ball t`oxhakut  
Knon per trimat që i lindi Zana  
Me kmish vesh e ngjesh tagana  
Kan dal malit per liri,  
Synin pishe turrin duhi,  
U than armiqve ktu s`kaloni,

## poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi

Market Pjetra e Martin Gjoni,  
Greku ban provokacion,  
Tulan Lulashi ne lufte po shkon,  
Erdhen vitet e clirimit,  
I prine Lotajt e Dukagjinit,  
Kane dal te fort si oficera,  
Mirash Marku e Lazer Pjetra,  
Edhe shteti per ta foli,  
Marash Kola e Lek Sokoli,  
Per kulture ja kan lan vetit,  
Prela e Ndoci te Grim Bicelit,  
Edhe ne sport Lotajt jan te parët,  
Njoft I kan te gjith shqiptarët,  
Kush Zef Marashit s'ia kaloi,  
Pushken ne shenj ai kur e vnoi,  
Ky Vat Mirashi i forte ka dalë,  
Muer medalje ne sport me kalë,  
Ne futboll e kan dhan ndihmen,  
Nikoll Gjergji me Armir Grimen,  
Ne mundje kush s'ja thej bejlegun,  
Tan Shqipria e njeh Ded Bregun,  
Edhe shteti e ka vlersue,  
"Mjeshter te madh" e ka nderue,  
Vera Bregu si zane e malit,  
Duel kampione e Ballkanit,  
Historia si uji rrjedhë,  
Brezi brezit ia percjellë,  
Vazhdojne vlerat rradhë- rradhë,  
Historia mbetet gjalle,  
Shkruhen vargjet fjala- fjalës,  
Se kta janë Lotajt e Shalës.

*Martin Kolë Kodra*

## GRIMCA HUMORISTIKE

"Mbarë e mbrapsht,  
gjuha e popullit asht ..."

1.  
Adhuroj prindit, kujtim kanë me mbetë,  
Jeta asht përpjekje e mësim  
Mbasi ata kanë me vdekë  
Nuk të vlen ma asnjë pendim

2.  
Kur kujton ditët e kalueme  
Dhe trazirat që iu ke qitë në rini  
Ndërgjegjen ke me pas të trazueme  
Se prindit për ty, do të ishin ba fli.

1.  
Kola çdo ditë delte në pazar  
Ushqime të blinte ku ishin ma lirë  
Kur shokët e shihnin ngarkuar si gomar  
-Djalit dhe nusen,- thoshte, - I kam të mirë

2.  
I thanë Zefit: Ke grue të mirë, për kokë  
E ai ua ktheu me të njëjtin metër:  
"E njoh unë ma mirë more shokë,  
Me ia pre kryet, menjëherë i del një tjetër".

3.  
Luli, djalë i vetëm, jetën e merr lehtë  
Me dalë në punë gjithnjë priton  
Nana i thotë: Çou, mjaft ke fjetë  
Se me sy nga qielli gja nuk fiton.

4.  
Sait agën për darkë e kishin thirrë  
Terevsa për te ishte shtru  
Ju erdhi pak vonë, edhe i pirë  
Ata i thanë: "Merre me lang se mishi u mbaru".

1.  
Të pashë fytyrën e u mahnita  
Flakë u ndezën sytë e mi  
Pa gjumë kaloi nata, vonë erdhi dita  
Moj syeshkruejma shtat selvi

1.  
Një gjel, kojshitë i shqetësonte  
Këndonte pa ikë nata  
Ia lyen prapanicën me vaj  
Tash filloi me këndue nga prapa

2.  
Një babë kishte djalin kapadai  
E porositi: "Kujdes, mos ndesh ndonjë hundlesh"  
Por një ditë si për çudi  
Iu kthye në shtëpi me hundët përshesh.

3.  
Metin shëndetlig për vizitë e çuen  
Familjarët në kujdes e patën  
Më vonë një punë i ofruan  
Më mblue konviktorët që zbuloheshin natën...

4.  
Erdhi behari e dekolitet shpërthyen si përherë  
Për dashuri, Nuzi kish ba mjaft emër  
Kur e pyetën: "Si po të duket kjo verë?"  
I'u tha: "Shih me sy e plas me zemër!"

5.  
Endej kafeve, e vonë gjente shtëpinë  
Se nuk shikonte as sahatin  
Kur vllaznit ndanë pasurinë  
Atij i dhanë vetëm...shtratin.

1.  
Meri rrinte e shqetësue në shtëpi  
Nga shihte se burrin po e lanë forcat  
U thoshte shoqeve: "Kam respekt për këtë njeri,  
Se dikur më ka pas shkri kocat".

2.  
E thirrën "mik" e mirë kaloi  
Po një mendim në krye i mbet  
"Ngado ndër miq e në botë të shkoj  
Si shpija e ime kërkund s'më ngjet".

3.  
Një babë me djalin e pati zanë halli  
Përditë tuj folun, përditë tuj e kqyr  
Kur e pyetën shokët se çka thotë djali  
Ofshani e tha: "Në burg shyqyr!"

1.  
Moj e dashtun, je tuj ma dredhë  
E tuj m'iu ba pasqyrë gjithkuj  
Shum' po vuaj e mendt' kam mbledhë  
Me u mbytë në një gotë ujë!

2.  
Me mall e gja, çifti shkoi gëzueshëm  
Ditë të bukura së bashku kaluen  
Por tash shoshoqin shikojn' idhnueshëm  
Se gjaja e malli, besa u mbaruen.

3.  
"Nipa e mbesa në shtëpi po rrisim",  
-tha gjyshe Roza, dhe kujtoi rininë...  
I biri me nusen, mbramjeve shetisin  
E gjyshja kërcune rrin e mban fëminë

4.  
Fejuan vajzën, prindit kaluan lumin  
Shtruen banket e u tund një krahinë  
Vajza mbas pak ditësh ndau të fejuemin  
Se ai e puthte vetëm ...në ballë!

## DASHURISË SË PARË

Megjithëse në pleqëri  
E gjallë ka mbetë në sytë e mi !

Erdh pranvera, natyra vesh rrobën e blertë të saj  
Erdh pranvera, qesh plak e i ri  
Lule shumëgjyrëshe kudo lulëzuan  
Gazin e harenë në çdo zemër shtuan!

Dhe hovet rinore shpërthyen përsëri  
Për jetën e bukur e plot dashuri  
Porsi lulet dhe kujtimet u zgjuan  
E njerëzit kangë e himne të dhuruan  
Sa edhe ma plakun, e ambla dashuri  
I jep forcë dhe e ban të ri!

Për një vashë një jetë mendova  
Prej saj mendjen kurrë s'e largova  
Deri një ditë që u takuam  
E për dashurinë tonë ambël biseduam

Koha kalonte, sa orë më dukej vjeti  
Dashuria mes nesh ngrihej si valë deti  
Çdo ditë që e bukur, çdo ditë e mbarë  
Ku shijoj ambël dashurinë e parë!

Tuej bisedue emocione të forta na ranë  
Sa që dhe pështymat në fyt na u thanë...  
Kur i dhashë puthjen e parë  
Për mua, që e imja gjithë bota mbarë  
Në krahë të njëri-tjetrit besën e prem-tuam  
E në qiejt e pafund së bashku fluturuam!

Himn natyrë për ty, që fale dashurinë  
Që rinon zemrat e lumturon njerëzinë

Të prisja në dritare kur bora ambël shtron  
Ti vije dhe u strukshe në kraharorin tim  
Në qoftë se bora tokën zbardhon  
Dashuria jonë ka vetëm gjelbërim!

Orarin e takimit me emocion e prita  
Kur ti vije fluturim, si zogu në fole  
Shpejt kalonte nata e shpejt zbardhte drita  
Ma t' lumtunit në botë, aty ishim ne!

Dhe pse ka dekada që flokët m'janë zbardhues  
Dashurinë e parë kurrë s'e kam harrue  
Të kujtoj çdo ditë e me shumë mall  
N'sytë e mendjes sime, je gjithnji e gjallë.  
*nga Haki Temali*

## TE DUASH ATDHEUN ...

Te duash atdheun s'është e njëlllojte,  
Si te duash një vajze simpatike,  
Si te zotërosh një takëm te florinjte,  
A si te adhurosh një vepër antike.

Te duash atdheun sinqerisht ne jete,  
Do t' thotë që pas tij te jesh i dashuruar,  
Kur diç s'i shkon mbare, t' prekesh me te drejte,  
Kur fjalë punët ka, t' ndjehesh i ngall-ezuar.

Çdo dashuri reale ka te veçantën:  
Ca te bëjnë te vuash i mikluar,  
Ca te humbësh krejt e te zësh lëngatën,  
Por me atdheun asnjë e krahasuar.

Nder shekuj shembuj atdhetarie,  
Njerëzimi përherë ka manifestuar.  
Atdheu për grithke-burim krenarie,  
Çdonjërit dashuri ç'i ka blatur.

## E BUKURA

Për te bukuren s'duhen te shumta fjale,  
Mëdyshje gjykimi se prej nga e ku gjen-det,  
Atë e sheh dhe ne qytet, krejt normal  
A ne një komune që qyteze donë te quhet  
Ku s'ka aq kushte te natyrshme te ndodhet.

Por ka te ngjare dhe ne një vend te humbur  
Te vëresh Hirushen tende te preferuar.  
Gjurmë, te pëlqeu, merre, pa u trembur,  
Kështu a s'veproi vete mbreti, pa ngurruar,  
Ari dhe ne dhë mbetet i vlerësuar.

E bukura –magjepse, shokuese,  
Për te Kupiditi shigjetat i gjakos,  
Sa ngazëlluese, aq relaksuese,  
Sa njerëz i shastis, sa zemra i plagos,  
E veçante, e përjetshme sfiduese.

*Nga Luan Qalliu*

## RUBAIR

Eshte mrekulli, kur adhuron një vajze,  
Por është me hyjnore, kur ajo te puth!  
Sikur del njëherësh, nga një bot' e lashte  
Dhe mbyllesh me endje, ne një buze te bute.

## EDHE NJËHERË

Do te doja n' blegërima kecash  
T'i prija tufës edhe njëherë,  
Tani, si poet, me libra vjershsh  
T'i bie gjethit, shtrirë, nen një ferre!

*Zëri i agut te zgjoje vjollcat,  
Anës burimit, ku dridhet një ledh.  
Te shoh si lahen retë dhe rosat  
Dhe erën e bores te përshëndes!*

*Pastaj diku, t'ia nisja këngën,  
Asaj që prushin s'ma shuan dot.  
Ne sy kaltërsi te zbusja brengen,  
Me vjollca buzët t'i mbushja plot!*

*Eja larushe, dorën me lëpi,  
Se e ngopa me bore burimi.  
Ah! Një çast te vetëm lërmë ta pi,  
Pastaj te fle, një ore harrimi!*

*Ne muzg zgjomë, moj zilke e tufës  
Te llastohemi te hëna ne stan,  
Pa le ta grise këmishën udhës  
Dhe vërmë, po deshe, nofkën çoban!*

*Nen gune ia vene te shtrihesh  
Dhe te ëndërrosh me balon përbri,  
Me shtojzovallen ne gjunjë te gdhihesh,  
Si aher' kur isha një çun i ri ...*

*Mehmet H. Gucia (Radonçiq)*

# Kaltërsi në mes kështjellash

- SHËNIME UDHËTIMI-

(vijon nga numri i kaluar)

Kush e filloi dhe nuk e realizoi? Sikur të më kishte lexuar mendimin në shprehjen e fytyrës sime, Agimi më shpjegon: -Ishte ëndrra e demokratit shkodran Pjetër Arbërori? Fatkeqësisht ai nuk është më. Dhe ...

Zbres shkallët e gurta të shekujve, për të gjetur ndonjë dëshmi, heshtje, lëvizje, luftime, apo gara lundrash të shtyrë me lopatat e drunjtë nga duart e fuqishme të peshkatarëve. Dhe ja lexojmë: "Ditë për ditë nga liqeni, që asht bri Shkodrës ... .vinin me lundra e barka me shumicë shqiptarë që banonin rreth e përqark atij liqeni ... suleshin si rrufeja mbi barbarët (Turqit S. M ...) Jemi në vitin 1477, rrethimi i parë i kështjellës së Shkodrës. Edhe anijet e Balshes së Tretë lëvizin në liqe si të xhindosura kundër atyre venedikase. E ndodhur në motin e 1410. Kërkoj të heq paralelet në pentagramet e kohës, por s'mundem, ka diçka që nuk shkon, që të shtrëngon, të mpinë. E kush është kjo vallë? Është ajo që s'duket, që përplasat mbi ne si një dallgë e më pas na tërheq e na fundos e përsëri na nxjerr në bregore me furi. E kështu në pafundësi. Por kjo gjendje vetëm për banorët varfanjak të këtyre anëve vallë?"

Hedh vështrimin luginës së Zarufes, ku dallohet ndonjë shtëpi dhe pylli i selvisë e mbjell rreth viteve gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar nga ndërmarja Pyjore Shkodër. Befasisht hapet qyteza e Shirokës, ku dallohet kisha e sapo ndërtuar dikur me emrin Shën Rrokut.

Ulemi në një restorant ku na prezantohet peshk i freskët, i gatuar me shije e të ofruar me një shërbim të kulturuar. Flladi i erës që sjell aromën e ujërave të liqenit, na ndjellin kënaqësi të madhe. Përgjatë malit shikojmë një brez të sapo djegur që ende "vjell" tym të zi. Duke biseduar me të zotën e lokalit Ilmi Rudaçin i cili na tregon: - Sapo gjuha e zjarrtë e flakëve kaluan kufirin, ne pamë një helikopter malazez që fluturonte pranë sipërfaqes ujore të liqenit, ai lëshoi disa tuba dhe qëndroi pezull për disa minuta e sakaq fluturoi në shpatet e Taraboshit. Nuk vonoi as edhe një orë dhe flakët u shuan. Ndërsa në krahun tonë ka muaj që digjen pyjet, kullotat dhe ...

Një vilë me bukuri magjepse, në arkitekturë, me pak gjelbërim përreth, na tërheq vëmendjen tone dhe tretim shikimin mbi të, edhe pse kjo duket si e "vdekur". Nga një burim historik lexojmë: "Me 1928 Bashkia e Shkodrës ka ndërtuar sipër vendbanimit të Shirokës një vilë të bukur për Presidentin Republikës Shqiptare Ahmet Bej Zogun ...". Largohe mi nga kjo qytezë me aromën e ujërave që ia japin, peshqit, algat e të tjera, ku mbretëron një qetësi absolute në gjithë pasqyrën ujore gati të pafund dhe në peizazhin përqark. Por kjo gjendje është ngecje në vend, është fashitje energjie, mbjellëse mjerimi e varfëri tek shoqëria e një periudhe të caktuar. Së paku kjo është filozofia që sapo vezulloi nga qelizat e trurit tim. Ndërsa bluaj me veten time se ashtu si u zëvendësua ura e drunjte mbi Bunë e ngritur ato dite qershori të shekullit të pesëm-

bëdhjetë, me ura të reja. Edhe me zhvillimin e ekonomisë e tregtisë në rrokullimën e shekujve e më pas për banorët e qytetit e fshatrave buzë liqenit deri më tani. Vallë a do të thyhet kjo heshtje e "mbjell" në bahçen e këtyre banorëve nga fshati Zogaj deri në Obot?! Shpresojmë!

Ura me stemën e Asburgëve Është mëngjes vere, ku rrezet e diellit sapo kanë ledhatuar kodrat e shumta përreth dhe Taraboshin hijerëndë. Rrugët e Oblikës së poshtme gumëzhijnë. Sigurisht nga rinia që ka ardhur nga mërgatat në Amerikë, Angli, Itali, Francë, Turqi e te tjerë. Shikoni këto shtëpi të reja me stilin arkitekturor perëndimor-më thotë xha Nuhi- janë ndërtuar me parat e sjell nga jashtë, pothuajse e vetmia burim jetese e zhvillimi.

E ndërsa vështroi kodrën e Kalldricës ku ndodhet depozita e ujit të pijshëm, e veshur me gjelbërim dhe me formë gjeometrike të një koni. I ngjanë kjo me të gjitha tiparet Kurorës së Çidhnës së epërme, apo asaj të Lurës, tashmë të zhveshur nga bimësia. Dhe më tej në shpatet e kurrizit që zbret nga maja e Vizit, një sipërfaqe ullishtash të Abas Salës të punuara e të krasitura me mjeshtëri. Me sa duket njerëzit e këtushëm kanë filluar të kuptojnë se pa punuar nuk vjen vaji i ullirit apo edhe ato të regjurar ne kavanoza.

Ullishtet i kemi nëpër të gjitha këto kodra përreth-më shkëputi vështrimin nga ky peizazh i mrekullueshëm Dritani, një djalosh energjik-por askush nuk interesohet t'iu bëjë shërbimet e nevojshme si në Toskanë të Italisë Qendrore. Kthehemi në pjesën Perëndimore që quhet Mavriçia një kurriz shumë i gjatë me ullishta dhe shknozë, dushqe të ndryshme dhe frashër e ndonjë tjetër me luginë të shumta duke prishur uniformitetin e relievit. Kërkoja nga njerëzit përreth si, Flamuri, Haxhi Mustafcani, Nazim Cenin të më tregonin disa emra vendesh në këto peizazhe të valëzuara si fletë fizarmonike, që veç zbresin drejt nesh me pjerësi gati të papërfillshme, por korra vetëm heshtje. Dikush i kishte harruar e të tjerë që nuk merrshin më me blegtorit e veprimtari në ruajtjen. shtimin e pyjeve apo pemëtari dhe për këto arsye ato fatkeqësisht, ishin futur ne zgavrat e përgjumura të harresës.

Rruga automobilistike ndjek përroin e Gomnave, i sistemuar me prita dhe i veshur shtrati me çimento. Kalojmë fshatin Micaj, ose Mace, por dialekti shkodrane e shqip-ton si të parin. Pyesim për origjinën e këtij emri por asgjë nuk dinin.

Këtu-tregon Agroni-Italianët kanë hapur një krua, por në nivelin e sipërfaqes së tokës. Për të mbushur ujë, ata ndërtuan shkallë, ku mbushnin ujë për ushtarët që i kishin në arat me teç çadrat ku ngrihej faqja e Dylabegut e gjelbëruar ku duket edhe kurrizi shkëmbor i Shytajve, aty këtu shquajmë ndonjë lis të tharë, ndoshta nga vera shumë e gjatë dhe pa pike shiu.

Ndodhemi në përroin e Durmeve, në të majtë është fshati me të njëjtin emër, edhe nga ky fshat ka pasur shume shpërngulje, megjithëse natyra edhe këtu është treguar bujare. Edhe ja nga sipër i kalon si gajtane,

një kurriz me shume përthyerje, ku here duken lugina e herë maja si dhëmbët e sharrës, me shpatet të pjerrëta, dhe që në fillim na kap syri varrezat e Mashkut, pikërisht këtu, para 1967 ka qenë një xhami e madhe me arkitekture të veçante dhe bukur mahnitëse. Më pas ajo u shemb si institucion fetar, materialet u zhdukën nga vendasit. Shyqyr zotit që mbeten varrezat, -na shpjegon-Nazim Beqiri duke më vështruar në sy.

Duke ecur shohim një urë, kjo me thonë është ndërtuar nga austriakët, gjatë luftës së Pare Botërore. Ka qenë shkruar edhe viti i ndërtimit e tani numrat kanë rënë, janë zhdukur. Në faqen e ballit të urës janë dy simbole një kryq dhe një figurë me formë të çrregullt. Më sipër është një urë tjetër e cila ka stemën e Asburgeve, dinastia e mbretërimit të tyre ka filluar me 1096 dhe përfundoi me 1918 në Austri. Edhe shqiponja me dy kërë me elementët përreth nga faktorët atmosferike janë hequr shumë pjesë duke e shpërfytyruar. Mjerisht e fatkeqësisht njëkohësisht, askush nuk është interesuar për riparimin e sajë. Një objekt i tillë muzeal me vlera të pallogaritshme historike e turistike.

Një qytetar austriak ka riparuar në vitin 2003 shkollën fillore për lagjen Xhaferraj, por banorët janë shpërngulur, kështu që shkolla ka mbetur e shkretë dhe dera prej dërrase e mbyllur me dry. Mbi shtëpinë e fisit Cenaj të ardhur nga krahina e Postribës. Shakotaj quhesh fshati i origjinës duke sjellë me vete edhe emrin e lagjes.. Ndodhemi në një rrugë të shtuar me kalldrëm guri, e cila vazhdon nga shtëpia e Malsorit buzë Bunës, ngjitet shpatave, luginave dhe kurrizeve ku arrin te Qafa e Lepurit, merr disa kthesa dhe del në Qafë Trinë - Durmej -Mashk. E gjitha kjo e ndërtuar, për qëllime ushtarake të projektuar e ndërtuar nga Austriakët. Të moshuarit kujtojnë se u vazhdua edhe nga Ushtretë italiane në luftën e dytë botërore. Teknika e punimit në mënyrën e vendosjes së gurëve, në zgjedhjen e tyre, në rregullsinë e vendosjes, tregojnë për një mjeshtri e projekt të hartuar e zbatuar me zgjuars i mjeshtri të lartë.

Kërkoj të qetësoj vetveten me këto peizazhe të buta ku përzihet ngjyra e argjende e ullishtave e kodrave të Xhaferrajve me bimësinë e rrallë shkurrrore të kodrës së Magjypëve, e shikoi luginën e Vizit që të zbret në mes dy kurrizeve në Micaj.

Tashmë lëmë pas Oblikën e Poshtme, më e populluara për të udhëtuar drejt fshatit Velinaj. Terreni fushor i rrethuar me kodra të ultë, të veshura kryesisht me dushk, dhe rrafshina qe futen ndër lugina i ngjajnë një pikturë peizazhistë të natyrës që të mahnitë dhe të zgjon kureshtjen.

Kalojmë ne urën me harqe, e cila për nga teknika e ndërtimit dhe stili i formës së harqeve, datohet treqind vjet më parë. Një xhami e re, me një minare te lartë, e cila ndritë nga bardhësia, është një institucion fetar i myslimanëve të shumtë të këtij fshati.

Ngjitur me të - na shpjegon Zamiri- ka qenë një kishë shumë vjetër. Shën Gjergji me sa me kujtohet, thirrsh. Ai më pas na tregon për Kodrën e Shmides duke drejtuar gishtin ne drejtim të ri, Rrajvet, Kodrës së Bajram Vllasit, pothuajse me e larta, Linës së vogël e cila është jo shumë larg nga shtëpia ime. Tanimë jam në fshatin Vukaj. Nga që dikur popullsia ka qenë krishtere kemi edhe toponimet vneshtet.

Duke shtuar kështu repertorin ne njo-

hjen e vendlindjes së tij, edhe pse ka mbi dhjetë vjet shtegtar në Firence të Italisë. Jo më shumë se dy brazza fisi i tyre quhej Uruçi dhe me pas u ndanë ne dy nën fise, Skuta e Besa. Për arsyen e thjeshtë se ishin fis shumë vatrash zjarri.

Ndërsa origjina e prejardhjes tonë - ndërhyjnë aty për aty Kujtimi - është nga malësitë e Reçit, nga andej kemi ramë në Krajë, dhe më vonë zbritëm në Obot e së fundi tek shtëpia e vjetër aty në atë kodrën sipër, të veshur me pemë e lisa.

Çdo fis ka historinë e tij të vazhdimësisë, në lëvizjet me lakore sipas kushteve ekonomiko-shoqërore, edhe kjo dukuri një lamë e madhe kërkimesh që historishk-ruesit e kanë vazhduar me penë, karte e studime. Ashtu qoftë!

Mbyllja

Mora nga këto peizazhe të bukura, pjalmin e jetës. Kërkoj të krijoi hibride te reja, me gjallesa gjithfarëshe, me karakterin e njerëzve, që të mund të gjejë shtigje të reja për të depërtuar në koracën e brishtë të shekujve me qëllim zbulimi e nxjerrje në dritën e diellit të vërtetave historike, në veprimtarinë e breznive përgjatë hullirave të kohërave.

Por e gjithë kjo ka lakoret e zigzaget e veta, të thepisura e të rrafshëta në monopetet e kohërave të cilat më vështirësojnë këtë ndërmarrje, por unë nuk do të ndalem, do ta ndjek xixëllonjen. Edhe pse këto njëzetë vitet e fundit fshatarët shpirtmirë, bujare e mikpritës, punëtore sa s'ka, mjeshtër të punimit të tokës e të rritjes së blegtorisë të fshatrave nën këmbët e Taraboshit si Krebejt, Muriqanët, Dramoshët, Elbacet, Dahatët, Vidhgarët dhe Vallasit e kanë braktisur, janë larguar, i kanë kthyer shpinën vendlindjeve të tyre. Sa e dhimbshme është kjo braktisje. Por çfarë të bësh!

Emrat e shoqëruesve te mijë kanë shëmbëllimin e ylberit shtatë ngjyrësh, emrat e ish mbretërve Ilirë me kryeqytet Shkodrën, apo shprehin agimin e bukur pranveror ku qyqja këndon me dashamirësi këngën e sajë, ndërsa dielli ngrohë tokën që avullon nga plugu i tërhequr nga traktori apo qetë, ndërsa drita është jeta vetë që ushqen veprimtarinë e gjallesave, dhe të njerëzsisë, duke vepruar me plotë energji për të vazhduar mbijetesën.

Malli më pushton të tërin, mallëngjimi më shtynë lotët të me rrëshqasin nga mol-lëzat e faqeve, e zemra me rreh fortë kur lë pas kalatë që janë ujitur me gjak njerëzish, e janë murosur kockat e tyre, e Barbana e dikurshme dëshmitarja ngjyre kaltër, shpresëdhënëse për të jetuar gjithmonë. Ripërtërihen e zëvendësohen breznitë, por gjithmonë e pashuar mbetet stafeta e kulturës e jetëve të shqiptarëve oblikase, këllmendasve, dukagjinave e te tjerë, të lidhur pazgjidhshmërisht si vargmalet kreshnike në hullitë e pafundme të mijëvjeçarëve.

Nga Dr. SELMAN MEZIU, Firence

## REDAKSIA

**Kryeredaktor: Lazër Kodra**  
**Redaktorë: Drita Shyti, Roza Pjetri, Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja, Zef Nika, Florenc Buxha, Lulash Brigja**